



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:903111

Datë: 09.03.2023

Numri i dokumentit: 04063629

CPP nr.1/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Milena Gjeriq, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. M. nga P., kundër të paditurës P. C. B., Sh.a, rr. ..., P., e përfaqësuar nga Firma e avokatisë "Vokshi & Lata", me avokat Florin Lata nga P., duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga paditësi, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.576/2021, datë 12.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitur nga paditësi E. M. nga P., kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.576/2021, datë 12.09.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.576/2021, datë 12.09.2022, është pranuar si i bazuar revizioni i të paditurës, P. C. B. dhe ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr 2610/17, i datës 26.06.2020, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 2230/13, i datës 23.03.2017, ashtu që: Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E. M. nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohen si jo ligjor, vendimi i të paditurës nr.13/881, i datës 14.08.2013, dhe vendimi nr. 13/969, i datës

02.09.2013, dhe të detyrohet e paditura P. C. B., Sh.a. në P., që paditësin ta kthej në punë dhe detyrat e tij, si zyrtar i shërbimeve bankare, si dhe t'ia kompensoj të ardhurat personale në shumën prej 17,679.00€, në emër të shpërblimit të dëmit në lartësinë e pagave të pa paguara për periudhën 29.09.2013 e deri më datë 30.11.2016, kontributin personal në vlerë prej 2,044.00€, si dhe tatimin në këto paga që e paditura duhet ti paguaj Administratës Tatimore në vlerë prej 1,125.00€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 09.09.2013 e deri më datën 30.11.2016, në shumën prej 2,005.95€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 1.098.80€. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, propozim për përsëritje të procedurës ka paraqitur paditësi dhe atë mbi bazën e nenit 232 pika f) dhe g) të LPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, kërkesën e palës paditëse për përsëritjen e procedurës ta aprovoi në tërësi si të bazuar dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme në Prishtinë Rev.nr.576/21 të datës 12.09.2022, ta ndryshoi ose në të kundërtën propozon, siç thuhet në revizion, që aktgjykimin e atakuar, ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura përmes të autorizuarit, Firma e avokatisë "Vokshi & Lata", me avokat Florin Lata është përgjigjur në kërkesën për përsëritjen e procedurës duke e kundërshtuar atë me pretendimin se nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet për përsëritjen e procedurës ashtu siç parashihen në ligj dhe ka kërkuar që të hedhet si e palejuar për shkak se është parashtruar pas afatit kohor të paraparë me ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 232 të LPK-së, shqyrtoi propozimin për përsëritjen e procedurës dhe gjeti se:

Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pabazuar.

Në këtë rast propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitur nga paditësi i referohet aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.576/2021, datë 12.09.2022, i cili aktgjykim nga është nxjerr kjo gjykatë nxjerr, kërkesa për përsëritje të procedurës është e pranueshme dhe rrjedhimisht kompetente për të vendosur sipas propozimit për përsëritje të procedurës është Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që gjykatat e instancës më të ulët nuk mundën ta anulojnë vendimin përfundimtar ndryshues të Gjykatës Supreme.

Paraprakisht me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 2230/13, të datës 23.03.2017, është vendosur që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit E. M. nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohen si jo ligjor vendimet e të paditurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në procedurën ankimore, me aktgjykimin e vet Ac.nr. 2610/17, të datës 26.06.2020, ka vendosur që të refuzohet e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës P. C. B., Sh.a, rr." ..., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2230/13, i datës 23.03.2017.

Sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, paditësi pretendon se mbi bazën e dispozitave të nenit 232 pika f) dhe g) gjykata duhet të aprovoi përsëritjen e sepse aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, është marr duke mos e konsideruar marrëveshjen jashtëgjyqësore që e ka arritur paditësi me të paditurën pas vendimit të gjykatës së shkallës së dytë. Me këtë marrëveshje palët janë pajtuar që paditësit t'i ndërpritet marrëdhënia e punës vullnetarisht ndërsa e paditura ta kompensoi paditësin me shumën prej 7,500.00€ dhe këtë marrëveshje pala nuk e ka paraqitur në shkresat e lëndës kurse tani mendon se ky fakt shkon në favor të një vendimmarrje tjetër nga ajo e gjykatës së revizionit.

Me vështrim në shkresat e lëndës del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, Ac.nr 2610/17, është marr më 26.06.2020, ndërkaq marrëveshja për ndërprerjen vullnetare të marrëdhënies së punës në mes të paditurës dhe paditësit është arritur më 25.09.2020, kurse aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.576/2021, mban datën 12.09.2022, më tepër se dy vite pas arritjes së marrëveshjes dhe asnjë pengesë propozuesi nuk e ka pas që ta paraqes në pretendimet e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me këtë vëren se propozimi për përsëritjen e procedurës si mjet i jashtëzakonshëm lejohet vetëm në rrethana të veçanta të caktuara të shkeljeve të rënda të dispozitave procedurale, ku si pasojë e këtyre shkeljeve të rënda të dispozitave procedurale nuk është nxjerrë vendimi i drejtë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të propozimit për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, ka gjetur se propozimi për përsëritjen e procedurës për shkaqet e treguara dhe dispozitën e nenit 232 par. 1 pika (f) të LPK-së, nuk është i bazuar për faktin se nuk qëndrojnë pohimet në kërkesën për përsëritjen e procedurës se aktgjykimi i Gjykata Supreme është bazuar në një vendim tjetër gjyqësor, ose në vendimin e ndonjë organi

tjetër, kurse ky vendim është ndryshuar, prishur apo anuluar në mënyrë të prerë. Në rastin konkret kjo marrëveshje midis palëve nuk është obligative dhe nuk paraqet relevancë për gjykatën e cila e vlerëson ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Sipas dispozitës së nenit 233 par. 2 të LPK, përsëritja e procedurës mund të kërkohej nga shkaqet e treguara në nenin 232 të këtij ligji, vetëm nëse pala pa fajin e saj, nuk ka mundur t'i parashtrijë këto rrethana para se të ketë marrë fund procedura e mëparshme me vendim gjyqësor të formës së prerë si në nenin 232 par.1 pika g) që parasheh se kërkesa mund aprovohet " në qoftë se pala merr dajeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme."

Në rastin konkret, kjo marrëveshje nuk përbën as një lloj baze mbi të cilën bazohet apo do të duhej të bazohet vendimmarrja e gjykatës së revizionit dhe nuk është relevante për gjykatën e revizionit. Pala parashtruese e propozimit e ka ditur për ekzistencën e marrëveshjes dhe paditësi ka qenë në dajeni, dhe e ka pas mundësinë ta përdorë para nxjerrjes së aktgjykimit të revizionit. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, prova të reja si arsye për përsëritjen e procedurës mund të jenë ose provat për të cilat pala nuk ka ditur se kanë ekzistuar në kohën e zhvillimit të procedurës gjyqësore, dhe për këtë shkak nuk ka mund t'i përdorë në procedurë të rregullt gjyqësore, ose provat për ekzistimin e të cilave ka ditur, por nuk ka pasur mundësi që t'i përdorë.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se propozimi për përsëritjen e procedurës në rastin konkret duhet refuzuar si i pa bazuar, për shkak se nuk janë të qëndrueshme pretendimet e propozuesit dhe nuk përmbushen asnjëra nga kushtet e parapara si në pikat f) dhe g) të nenit 232 të LPK-së, andaj u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

CPP nr.1/2023, më 07.03.2023

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami